VENDIM
Nr. 106, datë 22.4.2021

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 241, DATË 21.12.2020, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'HEC ZALL XHUXHË' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC 'XHUXHË 1', ME KAPACITET TË INSTALUAR 3487 kw, DHE HEC 'XHUXHË 2', ME KAPACITET TË INSTALUAR 1254 kw, DHE ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 4741 kw"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 56/2 prot., datë 19.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 241, datë 21.12.2020,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 241, datë 21.12.2020, ka vendosur të licencojë shoqërinë "HEC Zall Xhuxhë" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Zall Xhuxhë 1", me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC "Zall Xhuxhë 2", me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, për një afat 27 vjet e 9 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria të depozitojë në ERE:

i. licencën për drejtuesin teknik e elektrik;

ii. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

iii. studimin e fizibilitetit.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 451 prot., datë 16.3.2021, duke i rikujtuar detyrimin për plotësimin e kushteve të mësipërme.

- Në përgjigje me shkresën nr. 7 prot., datë 12.4.2021, protokolluar në ERE me nr. 451/1 prot., datë 12.4.2021, shoqëria ka depozituar në ERE licencën e drejtuesit teknik, vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe studimin e fizibilitetit.

- Me depozitimin e dokumentacionit të sipërcituar, shoqëria ka plotësuar kushtet e vendosura në pikën 1, germat "i", "ii" dhe "iii", të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 241/2020, ndaj këto kushte shfuqizohen, bazuar në përcaktimet e nenit 113, të KPA-së.

- Po ashtu, shoqëria ka depozituar shkresën e protokolluar në ERE me nr. 451/2 prot., me anë të së cilës ka deklaruar se dokumentacioni është dërguar me vonesë nga ana e saj, për shkak të infektimit të stafit administrativ të shoqërisë me *COVID-19*, çka ka sjellë pamundësinë e shoqërisë për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar brenda afatit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 241, datë 21.12.2020, pika 1 ishte:

"1. Të licencojë shoqërinë "HEC ZALL XHUXHË" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Zall Xhuxhë 1", me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC "Zall

Xhuxhë 2", me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, për një afat 27 vjet e 9 muaj, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja e këtij vendimi të depozitojë në ERE:

i. licencën për drejtuesin teknik e elektrik;

ii. vërtetimin për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;

iii. studimin e fizibilitetit.".

Bëhet:

"1. Të licencojë shoqërinë "HEC Zall Xhuxhë" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Zall Xhuxhë 1", me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC "Zall Xhuxhë 2", me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, për një afat 27 vjet e 9 muaj.".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti